



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.legjislacioni.gov.al

Nr. 75

Datë 28 maj 2014

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.284, datë 14.5.2014	Për miratimin e rregullave të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave elektronike të akteve	2689
Vendim i KM nr. 287, datë 14.5.2014	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilët preken nga restaurimi i objektit Merkato-Qendër, të bashkisë së Beratit	2690
Vendim i KM nr.288, datë 14.5.2014	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilët preken nga hapja dhe sistemimi i rrugës “11 Nëntori”, segmenti nga shkolla “Jorgji Dilo” deri te “Rotonda tek Posta”, të bashkisë së Elbasanit	2691
Vendim i KM nr. 293, datë 14.5.2014	Për një shtesë në vendimin nr. 53, datë 21.1.2009 të Këshillit të Ministrave, “Për ngarkimin e Ministrisë së Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime”, të ndryshuar	2693
Udhëzim i MBZHRAU nr. 217, datë 6.5.2014	Për rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje zhvillimore ndërtimore për objekte të llojit bujqësore dhe blegtorale, që miratohen në Këshillin Kombëtar të Territorit, si dhe për ngritjen e komisionit për shqyrtimin e tyre.....	2693
Udhëzim i MBZHRAU nr. 4 , datë 14.5.2014	Për produktet ushqimore dhe ingredientët ushqimorë të trajtuar me rrezatim jonizues.....	2696
Udhëzim i MBZHRAU nr. 6, datë 14.5.2014	Për tretësit ekstraktues të përdorur në prodhimin e produkteve ushqimore dhe përbërësve ushqimorë.....	2698
Urdhër i MD nr. 268, datë 16.5.2014	Për delegim kompetence.....	2700

Vendim i ERRU nr. 8, datë 31.3.2014	Për rinovim licence sh.a. Ujësjellës Gramsh.....	2701
Vendim i ERRU nr. 9, datë 21.4.2014	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. UK Fier...	2701
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Thoma Lashi	2701

VENDIM
Nr.284, datë 14.5.2014

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË
HOLLËSISHME PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E BRENDSHËM TË BAZËS SË
TË DHËNAVE ELEKTRONIKE TË AKTEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr. 10 325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, të nenit 12, pika 1, të ligjit nr. 96/2012, “Për Qendrën e Botimeve Zyrtare”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. ORGANIZIMI I BAZËS SË TË DHËNAVE ELEKTRONIKE TË AKTEVE

1. Baza e të dhënave elektronike të akteve administrohet nga Qendra e Botimeve Zyrtare (QBZ), me qëllim krijimin e bazës së të dhënave elektronike të akteve, duke përfshirë në të pasqyrimin në format elektronik të fletoreve zyrtare, akteve të botueshme dhe të akteve të përditësuara, së bashku me ndryshimet.

2. Objekt i këtij vendimi është krijimi i bazës së të dhënave elektronike të akteve, i cili përcakton të dhënat parësore dhe dytësore, dhënësin/dhënësit e informacionit, ndërveprimin me baza të tjera të të dhënave, si dhe nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara.

3. Të dhënat që përmban sistemi ndahen përkatësisht në:

a) të dhëna parësore, të cilat kanë të bëjnë me botimin e ligjeve, akteve normative të Këshillit të Ministrave, ministrave dhe drejtuesve të institucioneve qendrore, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, vendimet për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë, si dhe të gjitha aktet e tjera botimi i të cilave është i detyrueshëm me ligj;

b) të dhëna dytësore, të cilat kanë të bëjnë me të dhënat që do të merren nga ndërveprimi me baza të dhënash të tjera.

4. Institucioni administrues i sistemit dhe bazës së të dhënave është Qendra e Botimeve Zyrtare.

5. Dhënëse të informacionit janë të gjitha institucionet shtetërore të përmendura në shkronjën “a” të pikës 3 të këtij vendimi.

6. Kërkimi për lexim në bazën e të dhënave elektronike është i lirë për çdo subjekt të interesuar.

7. Baza e të dhënave elektronike të akteve përbëhet nga dy rubrika të veçanta:

- a) Fletoret zyrtare;
- b) Aktet e botuara.

8. Rubrikat përbëhen nga *link-e* të veçanta të vendosura në to, të cilat bëjnë të mundur aksesimin/kërkimin në mënyrë të drejtpërdrejtë në bazën e të dhënave elektronike të akteve.

9. Në rubrikën “Fletore zyrtare” gjenden të gjitha fletoret zyrtare të botuara në formatin elektronik.

10. Në rubrikën “Aktet e botuara” gjenden të botuara, në formatin elektronik, të gjitha aktet që janë të botuara në fletoret zyrtare:

- a) në versionin e tyre aktual në fuqi;
- b) në versionin e tyre fillestar të hyrjes në fuqi;
- c) të gjitha aktet ndryshuese.

Versioni sipas shkronjës “a” mund të përmbledhë edhe shkronjat “b” dhe “c”, duke bërë të mundur pasqyrimin e secilës prej tyre në një format të vetëm elektronik.

11. Rubrika “Akte të botuara” përfshin një nënrubrikë të veçantë, e cila përmban të gjitha aktet e botuara, të nxjerra në bazë dhe për zbatim të një akti tjetër të botuar. Kjo nënrubrikë do të përfshijë, dhe jo vetëm, të gjitha aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të një akti tjetër të botuar.

12. Identifikimi i akteve të botuara, në arkivin elektronik, kryhet nëpërmjet kërkimit të një ose disa të dhënave, si më poshtë vijon:

- a) Numri i aktit;
- b) Data e miratimit të aktit;
- c) Titulli i aktit;
- ç) Organi që e ka nxjerrë;
- d) Lloji i aktit;
- dh) Fusha e veprimtarisë së llojit të aktit;
- e) Numri dhe data e botimit të Fletores Zyrtare.

13. Në çdo rast, për botimin në bazën e të dhënave elektronike të akteve do të shërbejnë afatet ligjore të parashikuara në ligjin nr. 96/2012, “Për Qendrën e Botimeve Zyrtare”.

II. FUNKSIONIMI I BAZËS SË TË DHËNAVE ELEKTRONIKE TË AKTEVE

1. Në Qendrën e Botimeve Zyrtare caktohet sektori administrativ përgjegjës për funksionimin e bazës së të dhënave elektronike të akteve.

2. Pas përgatitjes për botim së çdo “Fletoreje zyrtare”, sipas kërkesave të ligjit nr. 96/2012, “Për Qendrën e Botimeve Zyrtare”, sektori përgjegjës, i përcaktuar sipas pikës 1 të këtij kreu, kryen:

- a) në të njëjtën kohë botimin e saj tek rubrika “Fletoret zyrtare”;
- b) botimin brenda një kohe sa më të shkurtër të akteve të botuara tek rubrika “Akte të botuara” dhe, nëse ka, duke bërë edhe përditësimet përkatëse.

3. Botimi i akteve sipas shkronjave “a” dhe “b” të pikës 2 të këtij kreu, bëhet në format PDF dhe në *Word*.

4. Botimi i të gjitha akteve, sipas këtij kreu, shfaqet në faqen zyrtare elektronike të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe nëpërmjet motorëve të kërkimit synohet të shfaqet e gjithë përmbajtja e tyre.

5. Kërkimi i avancuar i një akti të botuar bëhet mbi bazën e të dhënave që përmban faqja zyrtare elektronike e

Qendrës së Botimeve Zyrtare, e cila konsiston në klikimin sipas llojit të aktit, vitit, numrit, si dhe fjalëve kyçe që përmban akti.

6. Aktet e botuara në bazën e të dhënave elektronike të akteve do të jenë të botuara edhe sipas fushave të caktuara, të cilat do të jenë të ndara në nënkategori të specifikuara. Kërkimi nëpërmjet fushave të caktuara, synon të gjejë aktin më vete, përditësimet, si dhe, nëse ka, aktet nënligjore të nxjerra në bazë e për zbatim të tij.

III. TË NDRYSHME

1. Qendra e Botimeve Zyrtare duhet të vendosë në dispozicion të publikut mjete për të lehtësuar kërkimin e këtyre të dhënave.

2. Baza e të dhënave elektronike të akteve, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, bën të mundur të aksesohet edhe në baza të tjera të dhënash elektronike, të cilat administrohen nga institucione të tjera shtetërore e që përmbajnë akte të botueshme lidhur me to.

3. Ndërveprimi me bazat e tjera të të dhënave shtetërore dhe të dhënat dytësore, që botohen në bazën e të dhënave elektronike të akteve, përcaktohen me urdhër të ministrit të Drejtësisë, në përputhje me rregullat e miratuara në zbatim të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazën e të dhënave shtetërore”.

4. Qendra e Botimeve Zyrtare, në bashkëpunim me institucionet shtetërore, në cilësinë e dhënësit të informacionit, kujdeset që aktet e botueshme të pabotuara deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 96/2012, “Për Qendrën e Botimeve Zyrtare”, të botohen në formë elektronike në bazën e të dhënave elektronike të akteve, në një rubrikë të veçantë “Akte të pabotuara”. Për përmbajtjen e kësaj rubrike do të vlejnjë përcaktimet e bëra në pikat 10 dhe 12 të kreut I të këtij vendimi.

5. Ngarkohet Qendra Botimeve Zyrtare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 287, datë 14.5.2014

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILËT PREKEN NGA RESTAURIMI I OBJEKTIT, MERKATO-QENDËR, TË BASHKISË SË BERATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga restaurimi i objektit, Merkato-Qendër, të bashkisë së Beratit.

2. Shpronësimi bëhet në favor të bashkisë së Beratit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen sipas masës së dhënë në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 32 (tridhjetë e dy) m² truall, në vlerën 1 888 800 (një milion e tetëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 1 888 800 (një milion e tetëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) lekë të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Beratit, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Beratit.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas miratimit të projektit.

7. Regjistrimi i ri i pasurisë për sipërfaqen 32 (tridhjetë e dy) m² truall të bëhet në favor të bashkisë së Beratit.

8. Afati i përfundimit të punimeve të objektit të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Beratit.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe bashkia e Beratit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

TË DHËNA MBI LISTËN EMËRORE TË PRONARËVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN “PËR RESTAURIMIN E OBJEKTIT, MERKATO-QENDËR”, BASHKIA BERAT
Zona kadastrale 8502

Nr.	Emër, mbiemër	Nr. i pasurisë	Sipërfaqe/m ²	Çmimi në lekë/m ²	Vlera në lekë	Lloji i dokumentit
1	Ferdi Dura	8/139	5	59 025	295 125	Vërtetim pronësie
2	Beniamin Dura	8/139	12	59 025	708 300	Vërtetim pronësie
3	Hajrulla Dura	8/139	5	59 025	295 125	Vërtetim pronësie
4	Nuredin Seitaj	8/139	10	59 025	590 250	Vërtetim pronësie
	Totali		32		1 888 800	

VENDIM

Nr. 288, datë 14.5.2014

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILËT PREKEN NGA HAPJA DHE SISTEMIMI I RRUGËS “11 NËNTORI”, SEGMENTI NGA SHKOLLA “JORGJI DILO” DERI TE “ROTONDA TEK POSTA”, TË BASHKISË SË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga hapja dhe sistemimi i rrugës “11 Nëntori”, segmenti nga shkolla “Jorgji Dilo” deri te “Rotonda tek Posta”, të bashkisë së Elbasanit, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi bëhet në favor të bashkisë së Elbasanit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen sipas vlerave të mëposhtme:

a) Për sipërfaqen 4 850.18 (katër mijë e tetëqind e pesëdhjetë pikë tetëmbëdhjetë) m² truall, në vlerën 19 793 584.6 (nëntëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tetëdhjetë e katër pikë gjashtë) lekë;

b) Për sipërfaqen 1 823.24 (një mijë e tetëqind e njëzet e tre pikë njëzet e katër) m² banesë në vlerën 82 262 765.6 (tetëdhjetë e dy milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë gjashtë) lekë;

c) Për drufrutorët, në masën 581 601 (pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e një) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 125 803 483.3 (njëqind e njëzet e pesë milionë e tetëqind e tre mijë e katërqind e tetëdhjetë e tre pikë tre) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Elbasanit, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Elbasanit.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas miratimit të projektit.

7. Regjistrimi i ri i pasurive për sipërfaqet 4 850.18 (katër mijë e tetëqind e pesëdhjetë pikë tetëmbëdhjetë) m² truall, dhe 1 823.24 (një mijë e tetëqind e njëzet e tre pikë njëzet e katër) m² banesë, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

8. Afati i përfundimit të punimeve të objektit, hapja dhe sistemimi i rrugës “11 Nëntori”, segmenti nga shkolla “Jorgji Dilo” deri te “Rotonda tek Posta”, në bashkinë e Elbasanit, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe bashkia e Elbasanit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

TABELA PERBLEDEHESE
E VLERESIMIT TE SHPRONSIMIT TE FAMILJEVE PER EFEKT TE HAPJES SE RRUGES "11 NENTORI " (sot "Q.Stafa")
SEGMENTI NGA SHKOLLA "JORGJI DILO" DERI TEK " ROTONDA TEK POSTA "

Nr.	Familja	Nr Pasur	Vertetim proneste			TRUALL			BANESA			NJESI			DRUFRUT shpronsimi	SHPRONSIMI SHUMA	Verejtje	
			truall	banese	m2	shpronsim m2	ymimi lek/m2	shpronsim leke	Sip baneses m2	shpronsim leke/m2	preket	shpronsim leke	ymimi lek/m2	shpronsim leke				Sip njetee m2
1	Eduart Rivan Palluqi	15/248	252.00	77.40	0.00	19.23	4081	78477.63	6.82	19.16	45119	0.00	0.00	69719	0.00	942957.67		
2	Arian Hiderburg Leka	15/240	226.00	114.00	0.00	226.00	4081	922306.00	114.00	114.00	45119	0.00	0.00	69719	0.00	582000.0		
3	Bajdar Dervish Spahiu	15/446	189.00	86.00	0.00	149.22	4081	608966.82	86.00	86.00	45119	0.00	0.00	69719	0.00	6124072.00	0.0	
4	Vladimir, Iniklita Stefo	15/366	97.45	45.00	0.00	97.45	4081	397693.45	45.00	45.00	45119	0.00	0.00	69719	0.00	2430048.45	0.0	
5	Nazmi Ali Kovaci	15/443	0.00	0.00	32.50	0.00	4081	0.00	0.00	0.00	45119	0.00	0.00	69719	0.00	2000.0	0.0	
6	Nazmi Ali Kovaci	15/365	388.55	54.00	0.00	224.80	4081	917408.80	54.00	34.00	45119	2436426.00	0.00	0.00	69719	0.00	2265867.50	0.0
7	Nazmi Ali Kovaci	15/299	0.00	0.00	12.17	0.00	4081	0.00	0.00	0.00	45119	0.00	0.00	69719	0.00	15000.0	0.0	
8	Nazmi Ali Kovaci	15/298	0.00	0.00	37.00	0.00	4081	0.00	0.00	0.00	45119	0.00	0.00	69719	0.00	3368834.80	0.0	
9	Pronar pa vertetur (PPV)	15/48	745.00	94.00	0.00	66.25	4081	270366.25	66.25	94.00	45119	4241186.00	0.00	0.00	69719	0.00	848480.23	0.0
10	Mehmet Riza Cani	15/194	204.00	68.00	0.00	168.66	4081	688301.46	68.00	68.00	45119	3068092.00	0.00	0.00	69719	0.00	2579603.00	0.0
11	Mehmet Bajram Sefa	15/200	194.00	95.29	0.00	194.00	4081	791714.00	95.29	95.29	45119	4299389.51	0.00	0.00	69719	0.00	4511552.25	0.0
12	Shemsedin Cani (trash)	15/558	202.00	82.00	0.00	202.00	4081	824362.00	82.00	82.00	45119	3699758.00	0.00	0.00	69719	0.00	58800.0	0.0
13	Hajrte Cani etj. (trash)	15/36	320.00	0.00	0.00	262.15	4081	1069834.15	0.00	0.00	45119	0.00	0.00	69719	0.00	3815193.46	0.0	
14	Ali Shygyri Duhaxhiu	15/170	93.84	93.84	0.00	93.84	4081	382961.04	93.84	93.84	45119	4233966.96	0.00	0.00	69719	0.00	5119603.51	0.0
15	Nurije Jusuf Duhaxhiu	15/720	362.50	80.25	0.00	362.50	4081	1479362.50	80.25	80.25	45119	3620799.75	0.00	0.00	69719	0.00	4577120.00	0.0
16	Firdus Ali Duhaxhiu	15/153	334.00	56.00	0.00	116.00	4081	473396.00	56.00	56.00	45119	2526664.00	0.00	0.00	69719	0.00	1172434.15	0.0
17	Nazmi, Hali Duhaxhiu	15/232	149.00	70.00	0.00	149.00	4081	608069.00	70.00	70.00	45119	3158330.00	0.00	0.00	69719	0.00	4616928.00	0.0
18	Pronar pa vertetur (PPV)	15/368	173.00	0.00	0.00	173.00	4081	706013.00	0.00	0.00	45119	0.00	0.00	69719	0.00	47500.0	0.0	
19	Ali Zihni Çirakoli	15/191	34.00	0.00	0.00	34.00	4081	138754.00	0.00	0.00	45119	0.00	0.00	69719	0.00	3000060.00	0.0	
20	Arta, Andi, Dritan Demir Siba	15/380-2	0.00	53.00	0.00	0.00	4081	0.00	53.00	53.00	45119	2391307.00	0.00	0.00	69719	0.00	9000.0	0.0
21	Kujtim Demir Siba	15/380-3	0.00	60.00	0.00	0.00	4081	0.00	60.00	60.00	45119	2707140.00	0.00	0.00	69719	0.00	706013.00	0.0
22	Nazmi, Burbuqe Siba	15/380-1	0.00	113.00	0.00	0.00	4081	0.00	113.00	113.00	45119	5098447.00	0.00	0.00	69719	0.00	138754.00	0.0
23	Nazmi Demir Siba	15/318	20.50	50.00	20.50	20.50	4081	83660.50	50.00	50.00	45119	2255950.00	20.50	20.50	69719	1429239.50	2391307.00	0.0
24	Pronar pa vertetur (PPV)	15/373				150.06	4081	612394.86	0.00	0.00	45119	0.00	0.00	69719	0.00	5098447.00	0.0	
25	Pronar pa vertetur (PPV)	15/391				156.47	4081	638554.07	0.00	0.00	45119	0.00	0.00	69719	0.00	3768850.00	0.0	
26	Pronar pa vertetur (PPV)	15/30				129.32	4081	527754.92	0.00	0.00	45119	0.00	0.00	69719	0.00	647394.86	N Siba	
27	Xhevair Gani Tashani	15/186	403.90	0.00	0.00	381.40	4081	1556493.40	0.00	0.00	45119	0.00	0.00	69719	0.00	667054.07	A...Siba	
28	Xhevair Gani Tashani	15/189	8.60	0.00	0.00	8.60	4081	35096.60	0.00	0.00	45119	0.00	0.00	69719	0.00	605754.92	K...Siba	
29	Arstiri Ilia Nita	15/142	90.10	0.00	0.00	90.10	4081	367698.10	0.00	0.00	45119	0.00	0.00	69719	0.00	1556493.40		
30	Pronar pa vertetur (PPV)					0.00	4081	0.00	0.00	0.00	45119	0.00	0.00	69719	0.00	35096.60		
31	Pronar pa vertetur (PPV)	15/12	390.00	138.00	0.00	372.30	4081	1519356.30	138.00	138.00	45119	6226422.00	0.00	0.00	69719	6281681.90	6281682.90	A Nita
32	Pronar pa vertetur (PPV)	15/400				40.00	4081	163240.00	0.00	0.00	45119	0.00	0.00	69719	0.00	7764278.30	H Lleshi	
33	Hijmet Hysen Rizhuta (trash)	15/399	220.00	78.90	0.00	210.63	4081	859581.03	78.90	78.90	45119	3559889.10	0.00	0.00	69719	0.00	163240.00	0.0
34	Ndriçim, Shpetim, Elide Canija	15/285	695.00	257.00	0.00	453.00	4081	1848693.00	257.00	257.00	45119	11595583.00	0.00	0.00	69719	0.00	11000.0	0.0
35	Pronar pa vertetur (PPV)	15/268	51.80	51.80	0.00	51.80	4081	211395.80	51.80	51.80	45119	2337164.20	0.00	0.00	69719	0.00	36000.0	0.0
36	Haxhi Nezir Kapja	15/363	300.49	0.00	0.00	107.90	4081	440339.90	0.00	0.00	45119	0.00	0.00	69719	0.00	440339.90	0.0	
37	Shemsi Riza Lufja	15/256	140.00	0.00	0.00	140.00	4081	571340.00	0.00	0.00	45119	0.00	0.00	69719	0.00	240339.90	0.0	
38	Shemsi Riza Lufja	15/257	0.00	0.00	140.00	0.00	4081	0.00	0.00	0.00	45119	0.00	0.00	69719	0.00	571340.00	0.0	
39	Xhevair Halit Fanuku	15/260-N	0.00	24.00	0.00	0.00	4081	0.00	24.00	24.00	45119	1082856.00	0.00	0.00	69719	9760660.00	9760660.00	0.0
40	Nervus Liman Cenollari	15/6	0.00	40.00	0.00	0.00	4081	0.00	40.00	40.00	45119	1804760.00	0.00	0.00	69719	0.00	1082856.00	0.0
															581601.0	125803483.3		
															332.27	23165532.1		
															82262765.6	1823.24		

VENDIM
Nr. 293, datë 14.5.2014

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 53, DATË 21.1.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR NGARKIMIN E MINISTRISË SË BRENDSHME PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË, PËR DISA MALLRA E SHËRBIME", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 11 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe të shkronjës "b" të pikës 2 të vendimit nr. 1, datë 10.1.2007, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të pikës 1 të vendimit nr. 53, datë 21.1.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Përjashtimisht për vitin 2014, lejohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, si autoritet kontraktor, të realizojë vetë procedurat e prokurimit për:

- a) blerje uniformash, veshmbathjesh dhe elementesh të tjera përbërëse të tyre;
- b) blerje këpucësh."

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

UDHËZIM
Nr. 217, datë 6.5.2014

PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË KËRKESAVE PËR LEJE ZHVILLIMORE NDËRTIMORE PËR OBJEKTE TË LLOJIT BUJQËSORE DHE BLEGTORALE, QË MIRATOHEN NË KËSHILLIN KOMBËTAR TË TERRITORIT, SI DHE PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E TYRE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009, "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 939, datë 9.10.2013, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të

Ujërave", si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 502, datë 13.7.2011, "Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit", të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 199, datë 2.4.2014, "Për disa shtesa në vendimin nr. 480, datë 22.6.2011 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores model të planifikimit", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Ky udhëzim përcakton rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje zhvillimore, që miratohen në Këshillin Kombëtar të Territorit (KKT), nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU), si dhe ngritjen e komisionit për shqyrtimin e tyre. Trajtimi dhe përpunimi paraprak i kërkesës së subjektit që paraqet në MBZHRAU, një aplikim për marrje leje zhvillimore objektsh të natyrës bujqësore dhe blegtorale, bëhet nga komisioni që do të ngrihet në ministri, i cili mbulon fushën e aktivitetit, si dhe drejtoria përkatëse për objektet për të cilat është paraqitur kërkesa dhe aplikimi përkatës.

2. Një nga kriteret bazë, është ruajtja e fondit të tokës bujqësore në mënyrë që të mos bëhen ndërtime në tokat me bonitet nga 1- 4 (vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 410/2012), dhe për çdo leje zhvillimore bazat do të jenë instrumentet e planifikimit të hartuara në bazë të studimeve paraprake, bazuar në kriteret urbanistike dhe studimet e bëra.

2. Shqyrtimi i kërkesës së subjektit, që paraqitet në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, mbi aplikimin për marrje leje zhvillimore që miratohet në KKT për struktura apo punime brenda fushës së veprimtarisë shtetërore që mbulon MBZHRAU, bëhet nga komisioni teknik në ministri.

3. Komisioni teknik merr në shqyrtim kërkesën vetëm pasi ka verifikuar se subjekti ka kryer pagesën për "tarifën e aplikimit" (e përcaktuar në përmbushje të kërkesës së gërmës "c" seksioni 8, të formularit TIP 1, "Kërkesë për kryerje punimesh", shtojca 2 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 502, datë 13.7.2011, "Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit", të ndryshuar, "Fatura e pagesës për tarifën e aplikimit").

4. Vlera e tarifës së aplikimit është 10.000 (dhjetë mijë) lekë, pavarësisht nga lloji i strukturës për të cilën kërkohet leja e zhvillimit, e cila paguhet për llogari të MBZHRAU-së.

5. Për shqyrtimin e kërkesave për leje zhvillimore që miratohen në KKT, dhe përdorimi për struktura apo punime brenda fushës së veprimtarisë shtetërore që mbulon MBZHRAU, ngrihet "komisioni teknik", me përbërje si më poshtë:

- Sekretari i Përgjithshëm i MBZHRAU	kryetar
- Drejtoria e Prodhimit Bujqësor dhe Politikave Tregtare	2 (dy)
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Bujqësore dhe Peshkimit (veterinaria)	2 (dy),
- Drejtoria e Programimit dhe Vlerësimit të Politikave Rurale	2(dy)
- Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Tokave dhe Ujërave	2(dy)
- Drejtoria Juridike	1(një)
- QTTB Fushë - Krujë	2 (dy)

6. Përcaktimi i emrave në përbërje të komisionit teknik, për shqyrtimin e kërkesave për leje zhvillimore në MBZHRAU dhe Sekretariatit Teknik, bëhet nëpërmjet urdhrat të ministrit.

7. Komisioni për shqyrtimin e kërkesës për leje zhvillimore që miratohet në KKT, mbledhet me kërkesë të kryetarit sa herë që kërkohet shqyrtimi i praktikave për leje, sipas objektit të fushës së veprimtarisë së MBZHRAU-së që kanë impakt ekonomik, fushë të gjerë dhe interes publik, në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009, "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

8. Në njoftimin e dhënë nga kryetari, jepet edhe agjenda e mbledhjes së komisionit, si dhe vendi, data dhe ora e zhvillimit të mbledhjes.

9. Mbledhja e komisionit zhvillohet vetëm në rast se janë të pranishëm jo më pak se gjysma e anëtarëve të tij. Vetëm në rastin në pamundësi të pranisë së shumicës së anëtarëve, si më sipër, dhe vetëm për shqyrtimin e kërkesave për çështje të formës, mbledhja mund të kryhet me praninë e jo më pak se 3 anëtarëve të komisionit, së bashku me kryetarin.

10. Kryetari i komisionit cakton një person në rolin e sekretarit të këtij komisioni.

11. Kërkesa për leje zhvillimore komplekse i dërgohet menjëherë për shqyrtim komisionit teknik. Brenda 5 (pesë) ditëve pune nga dorëzimi i kërkesës, komisioni kryen shqyrtimin e kërkesës për çështje të formës.

12. Kërkesa për leje që miratohet në KKT, sipas objektit të fushës së veprimtarisë së MBZHRAU, duhet të përmbajë, sipas rastit:

a) Kërkesën për kryerje punimesh të plotësuar, në çdo pjesë të zbatueshme të saj nga kërkuesi i lejes së zhvillimit, sipas formularit TIP 1 të shtojcës 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 502, datë 13.7.2011, të ndryshuar.

b) Vërtetimin nga QKR-ja, për subjektin kërkues të lejes dhe zbatuesin e punimeve edhe për sa i përket faktit që nuk janë në gjendje likuidimi apo falimentimi.

c) Dokumentin që vërteton pronësinë mbi tokën që do të zhvillohet, sipas standardeve të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (certifikatë për vërtetimin e

pronësisë, kartela e pasurisë së paluajtshme, harta treguese e regjistrimit) dhe vërtetimin nga ZRPP-ja, në lidhje me pengesa apo kufizime të mundshme mbi pasurinë e paluajtshme, regjistrimin sipas kontratës së qirasë.

d) Pozicionin e zhvillimit në kuadër të planeve të miratuara për zonën përkatëse.

e) Plani i vendosjes së strukturës/strukturave, ku paraqiten kufijtë e pronave, gjurmët e rrugëve ekzistuese dhe ato të propozuara nga planet, distancat, tabela me llogaritjet e mënyrës së zbatimit të intensitetit dhe të koeficientit të shfrytëzimit të tokës për ndërtesa, rrugë dhe hapësirë publike. Ky plan shoqërohet edhe me rilevimin topogjeodezik, të firmosur nga organi ose individit me licencë gjeodezike.

ë) Raportin gjeologjik - sizmik- hidrologjik.

f) Plani i lidhjes së strukturës me infrastrukturën në zonë. Në këtë plan paraqiten edhe të gjitha infrastrukturën ekzistuese në zonë.

h) Plani i organizimit të punës dhe grafiku i punimeve dhe i mbikëqyrjes së punimeve me firmën origjinale të projektuesve. Në planin e organizimit të punimeve përcaktohet qartë edhe rrethimi i sipërfaqes së sheshit të kryerjes së punimeve, vendet e depozitimit të materialeve, vendi i tabelës informuese të ndërtimit, pozicioni i vinçit, depozitat e ujit për përdorim ndërtimi, skema e qarkullimit të mjeteve të transportit dhe mbrojtja e sigurimit teknik gjatë ndërtimit, në shkallën 1:500 dhe 1:200.

i) Projekti teknik i zbatimit dhe preventivi i realizimit të punimeve. Projekti teknik i zbatimit dorëzohet me firmë origjinale nga projektuesit, shoqërohet me tabelën e fletëve për secilin nga projektet përbërëse, si më poshtë dhe përmban:

a) projektin konstruktiv dhe planin e piketimit të strukturave;

b) projektin e plotë të ngrohjes dhe të ventilimit;

c) projektin elektrik dhe projektin për instalimet hidrosanitare;

d) parashikimin për vendosjen e kutisë postare;

e) paraqitjen e elementeve të projektit arkitektonik, që lehtësojnë aksesin apo eliminojnë pengesat për përdorimin e strukturës nga personat me aftësi të kufizuara;

f) tipat e ndarjeve funksionale të strukturës, sipas rastit, sipërfaqet për secilin tip dhe në total sasinë e njësive të ndarjeve funksionale, planimetritë për secilin tip;

g) projektin e mbrojtjes kundër zjarrit;

h) vërtetimin e kryerjes së pagesës për taksat dhe tarifat vendore për ndërtimin dhe/ose zhvillimin e tokës;

i) lejen mjedisore/ vlerësimin e ndikimit në mjedis, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

j) fotokopjen e noterizuar të licencave të projektuesve, si: arkitekti, konstruktori, inxhinierët elektrikë, hidro etj., të vlefshme brenda afatit të projektimit dhe të ndërtimit të strukturës;

nj) sipas rastit dhe llojit të zonës ku do të kryhen punimet, vërtetime, leje ose dokumente të tjera që kërkojnë nga legjislacioni në fuqi për sektorë apo punime të veçanta.

13. Në rast se dokumentacioni i kërkesës nuk është i plotë, subjekti njoftohet duke i lënë një afat 30-ditor për plotësimin e mangësive.

14. Në rast se dokumentacioni i kërkesës është i plotë, MBZHRAU boton menjëherë kërkesën për leje në Regjistrin e Planifikimit të Territorit dhe bashkërendon punën me bashkinë/komunën ku propozohet të kryhet zhvillimi, Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit dhe institucionet e tjera shtetërore dhe/apo operatorët e shërbimeve publike, sipas nenit 70/16 të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009, "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, për t'u siguruar se kërkesa është në përputhje me zhvillimin e lejuar në zonën përkatëse.

15. Komisioni bën afishimin në portalin e MBZHRAU-së, të njoftimit për kërkesën për leje zhvillimore që miratohet në KKT.

16. Mbledhja e komisionit teknik, për shqyrtimin e kërkesave për leje zhvillimore që miratohet në KKT, sipas objektit të veprimtarisë së MBZHRAU-së, bëhet jo më vonë se 5 ditë nga paraqitja e dosjes me të gjitha materialet dhe dokumentacionin përkatës, përfshirë edhe opinionet e drejtorive përkatëse teknike. Komisioni shqyrton kërkesën dhe merr vendimin brenda 10 ditë pune.

17. Komisioni për shqyrtimin e kërkesave në MBZHRAU bën trajtimin e çështjeve si më poshtë:

- Shqyrton kërkesat për dhënie leje zhvillimore që miratohet në KKT, brenda fushës së veprimtarisë shtetërore (objekte të fushës së bujqësisë dhe blegtorisë), që mbulon MBZHRAU, duke kryer:

a) kontrollin e rregullshmërisë (konform rregulloreve standarde për objektet e fushës së bujqësisë dhe blegtorisë) nga pikëpamja teknike dhe ligjore të dokumentacionit që shoqëron aplikimin;

b) mbi bazën e vlerësimit nga anëtarët e komisionit, si dhe duke pasur në konsideratë edhe opinionin nga drejtoritë respektive ose ekspertë të fushës, komisioni merr vendimin për:

i) pranim të kërkesës;

ii) refuzim të kërkesës, duke paraqitur te ministri informacionin me argumentet përkatëse, për shkaqet e refuzimit.

18. Komisioni merr vendim me shumicë votash.

Për çdo kërkesë që shqyrtohet, komisioni harton procesverbalin përkatës, i cili duhet të firmoset nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës në mbledhje.

Në rast refuzimi të kërkesës, MBZHRAU njofton subjektin aplikues duke dhënë edhe argumentet përkatëse për shkaqet e refuzimit. Subjekti aplikues ka të drejtën të aplikojë përsëri pasi të ketë plotësuar mangësitë e evidentuara.

19. Kundër vendimit të komisionit mund të bëhet ankim te Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

20. Sekretariati i komisionit teknik përgatit shkresën, e cila përcillet në AKPT për procedim të mëtejshëm, për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT), e cila përfshin:

- propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave;

- shqyrtimin e kërkesës për leje;

- një kopje të vendimit të komisionit teknik në lidhje me kërkesën për leje;

- dokumentacionin e plotë shoqërues të kërkesës për leje.

21. Pas dërgimit në MBZHRAU të vendimit të KKT-së për miratimin e lejes së zhvillimit, Sekretariati Teknik përgatit dokumentin administrativ teknik për zbardhjen e lejes, sipas formularit përkatës të vendimit nr. 502, datë 13.7.2011 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit", të ndryshuar.

22. Dokumenti administrativ teknik firmoset nga ministri në dy kopje origjinale.

23. Sekretariati i Komisionit Teknik nëpërmjet zyrës së protokollit të MBZHRAU-së, i dorëzon përfaqësuesit ligjor të subjektit aplikues apo të autorizuarit të tij, një kopje origjinale të firmosur të dokumentit administrativ teknik që i referohet vendimit të KKT-së për miratimin e lejes, jo më vonë se 10 ditë nga data e marrjes së vendimit nga KKT-ja.

24. Leja e përdorimit, në përfundim të punimeve jepet nga ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, pas vlerësimit nga komisioni teknik të dokumentacionit të depozituar, si vijon: procesverbalit dhe aktit të kolaudit, relacionit të mbikëqyrësit të punimeve, aktet e kontrollit, të përpiluara nga specialistët e komisionit teknik, aktet e kolaudit dhe/ose procesverbalet nga institucionet e rrjeteve të infrastrukturës.

25. Leja e përdorimit botohet në Regjistrin e Planifikimit të Territorit.

26. Në rast refuzimi të lejes së përdorimit, në zbatim të pikës 4 të nenit 79 të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009, "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, lëshohet akti i konstatimit të mospërputhshmërisë, i cili në pjesën e arsytimit u referohet dokumenteve të akteve të kontrollit.

27. Sekretariati i Komisionit Teknik, nëpërmjet zyrës së protokollit në MBZHRAU, i dorëzon përfaqësuesit ligjor të subjektit aplikues apo të autorizuarit të tij, një kopje origjinale të dokumentit të lejes së përdorimit, të firmosur nga ministri.

28. Dosja e plotë e dokumentacionit të kërkesës për leje zhvillimi, së bashku me opinionet teknike, lejet

përkatëse të zhvillimit dhe të përdorimit, depozitohen në arkivin e MBZHRAU-së.

29. Për ndjekjen e këtij udhëzimi, ngarkohen sekretari i Përgjithshëm i MBZHRAU-së, komisioni dhe Sekretariati Teknik.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ZHVILLIMIT RURAL
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Edmond Panariti

UDHËZIM
Nr. 4, datë 14.5.2014

**PËR PRODUKTET USHQIMORE DHE
INGREDIENTËT USHQIMORË TË TRAJTUAR
ME RREZATIM JONIZUES**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të nenit 23 të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Ky udhëzim do të zbatohet për prodhimin, tregtimin dhe importimin e produkteve ushqimore dhe përbërësve ushqimorë të trajtuar me rrezatim jonizues.

Ky udhëzim nuk do të zbatohet për:

a) ushqimet e ekspozuara ndaj rrezatimit jonizues të krijuar nga pajisjet e matjeve ose inspektimit, me kusht që doza e absorbuar nuk është më e madhe se 0,01 Gy për pajisjet e inspektimit, të cilat përdorin neutronet dhe 0,5 Gy në raste të tjera, në një nivel maksimal të energjisë së rrezatimit 10 MeV në rastin e rrezeve X, 14 MeV në rastin e neutroneve dhe 5 MeV në raste të tjera;

b) rrezatimin e produkteve ushqimore, të cilat janë përgatitur për pacientët që kërkojnë dieta sterile dhe janë nën mbikëqyrje mjekësore.

2. Produktet ushqimore të rrezatuara mund të vendosen në treg vetëm nëse janë në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi.

3. Produktet ushqimore që do t'i nënshtrohen rrezatimit jonizues, duhet të jenë në gjendje përshtatshmërisht të shëndetshme në kohën e trajtimit. Kushtet, të cilat duhet të plotësohen për autorizimin e trajtimit të produkteve ushqimore me rrezatim jonizues, janë përcaktuar në shtojcën I, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Rrezatimi mund të bëhet vetëm me anë të burimeve të listuara në shtojcën II, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 6 (a). Doza e përgjithshme mesatare e absorbuar llogaritet në përputhje me përcaktimet në shtojcën III, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Produktet ushqimore të autorizuar për trajtim rrezatues, si dhe rrezatimi maksimal i lejuar jepen në shtojcën IV, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

4. Doza maksimale e rrezatimit për produktet ushqimore mund të jepet në doza të pjesshme, por doza maksimale e lejuar e rrezatimit nuk duhet të tejkalohet në asnjë rast. Trajtimi me rrezatim nuk mund të përdoret në kombinim me ndonjë trajtim kimik që ka të njëjtin qëllim si trajtimi me rrezatim.

5. Etiketimi i produkteve ushqimore të trajtuara me rrezatim jonizues, të kryhet sipas përcaktimeve të mëposhtme:

a) në rastin e produkteve të destinuara për konsumatorin e fundit dhe në kuzhina e restorante:

i) nëse produktet ushqimore shiten si artikuj, fjalët “rrezatuar” ose “trajtuar me rrezatim jonizues” do të vendosen në etiketë në përputhje me nenin 5, pika 3, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1344, datë 10.10.2008, “Për miratimin e rregullores “Për etiketimin e produkteve ushqimore””. Në rastin e produkteve që shiten në masa të mëdha, këto fjalë do të vendosen së bashku me emrin e produktit në një ekran ose në njoftimin sipër ose pranë kontenierit, në të cilën produktet janë vendosur;

ii) nëse një produkt i rrezatuar është përdorur si përbërës, të njëjtat fjalë si në germën “i” do të shoqërojnë emërtimin e tij në listën e përbërësve. Në rastin e produkteve që shiten në sasi të mëdha, këto fjalë do të paraqiten së bashku me emrin e produktit në një ekran ose në njoftimin sipër ose pranë kontenierit, në të cilin produktet janë vendosur;

iii) pavarësisht përcaktimit në nenin 6, pika 7, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1344, datë 10.10.2008, “Për miratimin e rregullors “Për etiketimin e produkteve ushqimore””, të njëjtat fjalë si në germën “i”, kërkojnë të vendosen për të treguar përbërësit e rrezatuar të përdorur në prodhimin e përbërësve të përbërë të produkteve ushqimore, edhe në qoftë se këto përbëjnë më pak se 25% të produktit përfundimtar;

b) në rastin e produkteve jo të destinuara për konsumatorin e fundit dhe në kuzhina e restorante:

i) fjalët e parashikuara në pikën 5, germa “a”, do të përdoren për të treguar trajtimin e produkteve ushqimore dhe përbërësve ushqimorë që përmban një produkt ushqimor të rrezatuar;

ii) do të tregohet identiteti dhe adresa e objektit që ka kryer rrezatimin ose numri i tij i referimit siç parashikohet në pikën 6.

Treguesi i trajtimit, në të gjitha rastet, jepet në dokumentet shoqëruese ose të atyre që i referohen produktit ushqimor të rrezatuar.

6. Aprovimi i pajisjeve dhe subjekteve që kryejnë veprimtari të rrezatimit jonizues, bëhet në përputhje me ligjin nr. 8025, datë 9.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) bashkëpunon me Komisionin e Mbrojtjes nga Rrezatimi dhe merr e mban informacionin e mëposhtëm:

a) emrin, adresën dhe numrin e referencës të pajisjes rrezatuese, e cila është e miratuar, dokumentin e miratimit, si dhe çdo vendim pezullimi apo tërheqje të miratimit;

b) rezultatet e kontrolleve të kryera në pajisjet me rrezatim jonizues, në veçanti në lidhje me kategoritë dhe sasinë e produkteve të trajtuara dhe dozave të administruara;

c) një raport në bazë të informacionit të dhënë çdo vit nga autoriteti kombëtar mbikëqyrës.

8. AKU kontrollon dhe mban rezultatet e kontrolleve të kryera në fazën e tregtimit të produktit.

9. Subjektet e miratuara që kryejnë rrezatim jonizues, në përputhje me pikën 6, duhet që për çdo burim të rrezatimit jonizues të përdorur, të mbajnë të dhëna që tregojnë për secilën ngarkesë të ushqimeve të trajtuara:

a) natyrën dhe sasinë e produkteve ushqimore të rrezatuara;

b) numrin e ngarkesës;

c) personin që ka kryer trajtimin me rrezatim;

d) marrësin e ushqimeve të trajtuara;

e) datën e rrezatimit;

f) materialet e paketimit të përdorura gjatë trajtimit;

g) të dhënat për kontrollin e procesit të rrezatimit siç parashikohet në shtojcën III, kontrollet dozimetrike të kryera dhe rezultatet e marra, të dhëna të hollësishme në veçanti në kufijtë e poshtëm dhe të sipërm të dozës së absorbuar dhe llojin e rrezatimit jonizues;

h) referenca për matjet e validimit (miratimit) të dozave fillestare.

10. Të dhënat e përmendura në pikën 9 mbahen për një periudhë prej pesë vjetësh.

11. Një produkt ushqimor i trajtuar me rrezatim jonizues mund të importohet vetëm nëse është:

a) në përputhje me kushtet të cilat zbatohen për këto produkte ushqimore;

b) i shoqëruar me dokumente që tregojnë emrin dhe adresën e subjektit, i cili ka kryer trajtimin me rrezatim dhe që sigurojnë informacionin e përcaktuar në pikën 9.

12. Materialet e përdorura për ambalazhimin e produkteve ushqimore të rrezatuara, duhet të jenë të përshtatshme për ambalazhimin e kësaj kategorie produktesh ushqimore.

13. Ngarkohet Drejtoria e Sigurisë Ushqimore dhe Peshkimit, si dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ZHVILLIMIT RURAL
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Edmond Panariti

SHTOJCA I

KUSHTET PËR AUTORIZIMIN E RREZATIMIT TË PRODUKTEVE USHQIMORE

1. Rrezatimi i produkteve ushqimore mund të autorizohet vetëm nëse:

a) është një domosdoshmëri teknologjike;

b) nuk paraqet rrezik për shëndetin e njerëzve dhe bëhet nën kushtet e lejuara;

c) është në dobi të konsumatorit;

d) nuk është përdorur si një zëvendësues i praktikave të higjienës dhe shëndetësore ose të praktikave të mira të prodhimit ose atyre bujqësore.

2. Rrezatimi i produkteve ushqimore mund të përdoret vetëm për qëllimet e mëposhtme:

a) për të reduktuar incidencën e sëmundjeve që vijnë nga ushqimi duke shkatërruar mikroorganizmat patogjene;

b) për të reduktuar prishjen e produkteve ushqimore nga ngadalësimi ose frenimi i procesit të prishjes dhe shkatërrimin e organizmave të prishjes;

c) për të reduktuar humbjen e ushqimeve me pjekjen e parakohshme, rritjen apo mbirjen;

d) për të çliruar produktet ushqimore nga organizmat e dëmshme të bimëve ose produkteve bimore.

SHTOJCA II

BURIMET E RREZATIMIT JONIZUES

Produktet ushqimore mund të trajtohen vetëm nga këto burime të rrezatimit jonizues:

a) rrezet gama nga bërthama rrezatuese ^{60}Co ose ^{137}Cs ;

b) rrezet X të gjeneruara nga burime të makinës që veprojnë në ose nën energjinë e nivelit nominal (maksimumi i energjisë kuantike) prej 5 MeV;

c) elektronet e gjeneruara nga burimet e makinës që veprojnë në ose nën energjinë e nivelit nominal (maksimumi i energjisë kuantike) prej 10 MeV.

SHTOJCA III

1. DOZIMETRIA

Doza mesatare e përgjithshme e absorbuar

Doza mesatare e përgjithshme e absorbuar mund të merret për qëllim të përcaktimit të shëndetshmërisë së produkteve ushqimore të trajtuara me një dozë të përgjithshme mesatare prej 10 kGy ose më pak se të gjitha efektet kimike të rrezatimit në atë varg të caktuar të dozës të cilat janë proporcionale me dozën.

Doza mesatare e përgjithshme, D , është përcaktuar nga integrali i mëposhtëm mbi vëllimin e përgjithshëm të mallrave:

$$D = \frac{1}{M} \int p(x,y,z) dV$$

ku:

M = masa totale e mostrës së trajtuar p = densiteti lokal në pikën (x, y, z) d = doza lokale e absorbuar në pikën (x, y, z) $dV = dx dy dz$, elementi pambarimisht i vogël i vëllimit, i cili në raste të vërteta është e përfaqësuar nga fraksionet e vëllimit. Doza mesatare e përgjithshme e absorbuar mund të përcaktohet direkt për produktet homogjene ose për mallrat e mëdha me dendësi të dukshme homogjene përcaktohet duke shpërndarë një numër të përshtatshëm dozimetrie, strategjike dhe në mënyrë të rastësishme, në të gjithë volumin e mallrave. Nga shpërndarja e dozës së përcaktuar në këtë mënyrë, mund të llogaritet një mesatare e cila është doza mesatare e përgjithshme e absorbuar. Nëse forma e kurbës së shpërndarjes së dozës nëpërmjet produktit është e përcaktuar mirë, pozicionet e dozës minimale dhe maksimale janë të njohura. Matjet e shpërndarjes së dozës në këto dy pozicione në një seri të mostrave të produktit mund të përdoren për të dhënë një vlerësim të përgjithshëm të dozës mesatare.

Në disa raste, vlera mesatare e vlerave mesatare të dozës minimale (D_{min}) dhe dozës maksimale (D_{max}), do të jetë një vlerësim i mirë i dozës së përgjithshme: p.sh., në këto raste:

$$\text{doza mesatare e përgjithshme} \approx \frac{D_{min} + D_{max}}{2}$$

Raporti $\frac{D_{max}}{D_{min}}$ nuk duhet të kalojë 3.

2. PROCEDURAT

2.1 Përpara se të fillojë rrezatimi rutinë i një kategorie të caktuar të produkteve ushqimore në një strukturë rrezatimi, duhet të përcaktohen dozat maksimale dhe minimale duke bërë matjet e dozës gjatë të gjithë vëllimit të produktit.

Këto matje të vlefshmërisë duhet të kryhen për një numër herësh të përshtatshme (p.sh. 3-5 herë), në mënyrë që të bëjë kompensim për variacionet në dendësinë apo formën e produktit.

2.2 Matjet duhet të përsëriten sa herë që është ndryshuar produkti, forma e tij apo kushtet e rrezatimit.

2.3 Gjatë procesit, matjet e dozës rutinë kryhen në mënyrë që të sigurohet se kufijtë e dozës nuk janë tejkaluar. Matjet duhet të kryhen duke vendosur dozimetra në pozicionet e dozës maksimale ose minimale, ose në një pozicion reference. Doza në pozicionin e referencës duhet të lidhet në mënyrë të matshme me dozën maksimale dhe minimale. Pozicioni i referencës duhet të gjendet në një pikë të përshtatshme në ose mbi produkt, ku ndryshimet e dozës janë të ulëta.

2.4 Matjet e dozës rutinë duhet të kryhen në çdo ngarkesë të produkteve ushqimore dhe në intervale të rregullta gjatë prodhimit.

2.5 Në rastet kur janë rrezatuar produkte të paambalazuara të rrjedhshëm, vendndodhjet e dozës minimale dhe maksimale nuk mund të përcaktohen. Në një rast të tillë është e preferueshme për të përdorur një dozimetër të rastësishëm për marrjen e mostrave për të përcaktuar vlerat e këtyre ekstremeve të dozave.

2.6 Matjet e dozës duhet të kryhen duke përdorur sisteme dozimetrike të njohura, dhe matjet duhet të jenë të gjurmueshme me standardet fillestare.

2.7 Gjatë rrezatimit, parametra të caktuar të objektit duhet të kontrollohen dhe të regjistrohen në mënyrë të vazhdueshme. Për objektet me bërthamë rrezatuese parametrat përfshijnë shpejtësinë e transportit të produktit ose kohën e kaluar në zonën e rrezatimit dhe treguesin pozitiv për pozicionin e saktë të burimit. Për objektet përsheptuese, parametrat përfshijnë shpejtësinë e transportit të produktit dhe nivelin e energjisë, rrjedhjen e elektroneve dhe gjerësinë e skanimit të objektit.

SHTOJCA IV

PRODUKTET USHQIMORE TË AUTORIZUARA PËR TRAJTIM RREZATUES DHE RREZATIMI MAKSIMAL

Kategoria e produkteve ushqimore	Doza mesatare maksimale e rrezatimit të absorbuar (kGy)
Beharna aromatike të thata, erëza dhe erëza perimesh	10

UDHËZIM

Nr. 6, datë 14.5.2014

PËR TRETËSIT EKSTRAKTUES TË PËRDORUR NË PRODHIMIN E PRODUKTEVE USHQIMORE DHE PËRBËRËSVE USHQIMORË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të nenit 23 të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Ky udhëzim do të zbatohet për tretësit ekstraktues të përdorur ose të paracaktuar për t'u përdorur në prodhimin e produkteve ushqimore ose përbërësve ushqimorë. Ai do të zbatohet gjithashtu për tretësit ekstraktues, të përdorur ose të paracaktuar për t'u përdorur në prodhimin e produkteve ushqimore ose përbërësve ushqimorë që importohen në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ky udhëzim nuk do të zbatohet për tretësit ekstraktues të përdorur në prodhimin e aditivëve ushqimorë, vitaminave dhe aditivëve të tjerë ushqyes (nutricional), përveç aditivëve ushqimorë, vitaminave ose aditivëve ushqyes (nutricional) të listuara në shtojcën I të këtij udhëzimi.

2. Për qëllim të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “Tretës” nënkupton çdo substancë për tretjen e një produkti ushqimor ose çdo komponent të tij, duke përfshirë çdo papastërti të pranishëm në ose mbi atë produkt ushqimor.

b) “Tretës ekstraktues” nënkupton një tretës që është përdorur në një procedurë ekstraktimi gjatë përpunimit të lëndëve të para ose produkteve ushqimore, ose të komponentëve, ose përbërësve të këtyre produkteve dhe të cilat janë larguar, por që mund të rezultojë prania e mbetjeve ose derivateve në produktet ushqimore apo përbërësit ushqimorë, pasi teknikisht është e pashmangshme.

3. Përdorimi i tretësve ekstraktues në prodhimin e produkteve ushqimore ose përbërësve ushqimorë të listuar në shtojcën I, të bëhet nën kushtet e përdorimit dhe në maksimumin e kufijve të mbetjeve të përcaktuara në këtë shtojcë.

4. Uji në të cilin mund të jenë shtuar substanca që rregullojnë aciditetin ose alkalinitetin, si dhe substanca të tjera ushqimore, të cilat kanë veti tretëse, lejohen të përdoren si tretës ekstraktues në prodhimin e produkteve ushqimore ose përbërësve ushqimorë.

5. Substancat dhe materialet e listuara në shtojcën I, si tretës ekstraktues duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme të pastërtisë, si më poshtë:

a) nuk duhet të përmbajnë një sasi toksikologjikisht të rrezikshme të çdo elementi ose substance;

b) nuk duhet të përmbajnë më shumë se 1 mg/kg arsenik ose më shumë se 1 mg/kg plumb.

6. Substancat e listuara në shtojcën I dhe të destinuara për përdorim si tretës ekstraktues në produktet ushqimore mund të tregtohet vetëm nëse paketimi, kontejnerët e tyre ose etiketat, mbajnë të dhënat e mëposhtme, në mënyrë të tillë që të jenë lehtësisht të dukshme, qartësisht të lexueshme dhe të pashlyeshme:

a) emrin tregtar, siç është dhënë në shtojcën I;

b) një tregues të qartë që materiali është i një cilësie të përshtatshme për t’u përdorur për ekstraktimin e produkteve ushqimore ose përbërësve ushqimorë;

c) një referencë, nga e cila mund të identifikohet ngarkesa ose lot-i;

d) emrin ose emrin e biznesit dhe adresën e prodhuesit ose paketuesit apo të një shitësi nga është blerë;

e) sasia neto dhënë në njësi vëllimi;

f) nëse është e nevojshme, kushtet e veçanta të ruajtjes ose kushtet e përdorimit.

Të dhënat e mësipërme duhet të jenë në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme nga blerësit, përveç rasteve kur masa të tjera janë marrë për të siguruar që blerësi është i informuar. Këto të dhëna duhet të jenë në gjuhën shqipe krahas gjuhëve të tjera.

7. Në përjashtim nga paragrafi 1 të pikës 6, të dhënat e përcaktuara në gërmat “c”, “d”, “e” dhe “f” më sipër, mund të paraqiten vetëm në dokumentet tregtare që kanë të bëjnë me ngarkesën ose lot-in në rastet kur ato duhet të paraqiten para shpërndarjes.

8. Pika 6 dhe 7 nuk do të cenojë dispozitat më të plota ose më të detajuara në fuqi në lidhje me peshat dhe masat apo dispozitat në fuqi që zbatohen për klasifikimin, paketimin dhe etiketimin e substancave dhe përzierjeve të rrezikshme.

9. Aditivët ushqimorë, vitaminat dhe aditivët e tjerë ushqyes (nutricional) të përdorur në produktet ushqimore, nuk duhet të përmbajnë nivele të rrezikshme për shëndetin e njeriut të mbetjeve të tretësve ekstraktues.

10. Ngarkohet Drejtoria e Sigurisë Ushqimore dhe Peshkimit, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, si dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUIQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Edmond Panariti

SHTOJCA I
TRETËSIT EKSTRAKTUES TË CILËT MUND TË
PËRDOREN GJATË PËRPUNIMIT TË LËNDËVE
TË PARA, PRODUKTEVE USHQIMORE,
KOMPONENTËVE USHQIMORË OSE
PËRBËRËSVE USHQIMORË

PJESA I
TRETËSIT EKSTRAKTUES QË DO TË PËRDOREN
NË PËRPUTHJE ME PRAKTIKËN E MIRË TË
PRODHIMIT PËR TË GJITHA PËRDORIMET ⁽¹⁾

Emri:

Propan

Butan

Acetat etili

Etanol

Dioksis carbon

Aceton ⁽²⁾

Oksid azoti

1. Një tretës ekstraktues konsiderohet se është përdorur në përputhje me praktikën e mirë të prodhimit, në qoftë se nga përdorimi i tij rezultojnë vetëm prani e mbetjeve ose derivateve në sasi teknikisht të pashmangshme që nuk paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut.

2. Përdorimi i acetonit në rafinimin e vajit të bërësisë së ullirit është i ndaluar.

PJESA II

TRETËSIT EKSTRAKTUES PËR TË CILËT JANË SPECIFIKUAR KUSHTET E PËRDORIMIT DHE KUFIJTË MAKSIMALË TË MBETJEVE

Emri	Kushtet e përdorimit (përmbledhje e përshkrimit të ekstraktimit)	Kufijtë maksimalë të mbetjeve në produktet ushqimore ose përbërësit ushqimorë të ekstraktuar
Heksan ⁽¹⁾	Prodhim ose fraksionim i yndyrave dhe vajrave dhe prodhimin e gjalpët të kakaos	1 mg/kg në yndyrë ose vaj ose gjalpin e kakaos
	Përgatitja e produkteve proteinike pa yndyrë dhe miellrave pa yndyrë	10 mg/kg në produkte ushqimore që përmbajnë produkte proteinike pa yndyrë dhe miellra pa yndyrë
	Përgatitja e embrionit të drithërave pa yndyrë	30 mg/kg në produktet e pa yndyrë të sojës të shitura te konsumatori i fundit
Acetat metili	Heqja e kafeinës ose heqja e ngacmuesve dhe hidhësirës nga kafja dhe çaji	5 mg/kg në embrionin e drithërave pa yndyrë
	Prodhimi i sheqerit nga melasa	20 mg/kg në kafe ose çaj
Etilmetilketon ⁽²⁾	Fraksionimi i yndyrave dhe vajrave	1 mg/kg në sheqer
	Heqja e kafeinës ose heqja e ngacmuesve dhe hidhësirës nga kafja dhe çaji	5 mg/kg në yndyrë ose vaj
Diklormetan	Heqja e kafeinës ose heqja e ngacmuesve dhe hidhësirës nga kafja dhe çaji	20 mg/kg në kafe ose çaj
Metanol	Për të gjitha përdorimet	2 mg/kg kafe të pjekur dhe 5 mg/kg në çaj
Propan-2-ol	Për të gjitha përdorimet	10 mg/kg

⁽¹⁾ Heksan nënkupton një produkt komercial që përbëhet kryesisht nga hidrokarbure aciklike të ngopura që përmbajnë gjashtë atome karboni dhe distilon midis 64°C dhe 70°C. Përdorimi i kombinuar i heksanit dhe etilmetilketonit është i ndaluar.

⁽²⁾ Niveli i n-heksan në këtë tretës nuk duhet të kalojë 50 mg/kg. Përdorimi i kombinuar i heksanit dhe etilmetilketonit është i ndaluar.

PJESA III

TRETËSIT EKSTRAKTUES PËR TË CILËT JANË SPECIFIKUAR KUSHTET E PËRDORIMIT

Emri	Kufijtë maksimalë të mbetjeve në produktet ushqimore për shkak të përdorimit të tretësve ekstraktues në përgatitjen e aromatizuesve nga materiale aromatizues natyrore
Dietil eter	2 mg/kg
Heksan ⁽¹⁾	1 mg/kg
Cikloheksan	1 mg/kg
Acetat metili	1 mg/kg
Butan-1-ol	1 mg/kg
Butan-2-ol	1 mg/kg
Etilmetilketon ⁽¹⁾	1 mg/kg
Diklormetan	0.02 mg/kg
Propan-1-ol	1 mg/kg
1,1,1,2-tetrafluoretan	0.02 mg/kg

⁽¹⁾ Kombinimi i heksanit me etilmetilketonin është i ndaluar.

URDHËR

Nr. 268, datë 16.5.2014

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të ligjit nr. 9000 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë nga data 19.5.2014 deri në datën 23.5.2014, zëvendësministrave të Drejtësisë z. Arben Isaraj dhe z. Idlir Peçi, brenda fushës së kompetencave të deleguara me urdhrin nr. 7, datë 8.1.2014, të Ministrit të Drejtësisë.

2. Ngarkohen zëvendësministrat e Drejtësisë z. Arben Isaraj dhe z. Idlir Peçi për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Nasip Naço

VENDIM
Nr. 8, datë 31.3.2014

PËR RINOVIM LICENCE SHA UJËSJELLËS
GRAMSH

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë", Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Rinovim licence për efekt të përfundimit të afatit të operatorit sh.a. Ujësjiellës Gramsh, me:

Drejtues ligjor: Tajar Bici

Drejtues teknik: Miranda Bici.

2. Operatori sh.a. Ujësjiellës Gramsh autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është: bashkia Gramsh; komunat: Pishaj, Kodovjakë, Kushovë, Tunjë, Sult.

4. Kjo licencë është e vlershme për një periudhë 4-vjeçare deri më 30.3.2018.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM
Nr. 9, datë 21.4.2014

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR
KONSUM PUBLIK PËR SHA UK FIER

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, metodologjisë "Për vendosjen e tarifave", si dhe vendimit të KKRR-së nr. 35, datë 14.10.2013, "Për miratimin e përqindjes së pagesës rregullatore për vitin 2014", Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave të sh.a. UK Fier

a) Tarifë volumetrike për shërbimet:

	Furnizimi me ujë	Largimi i ujërave të ndotura
Konsumator familjar	52 lekë/m ³	13 lekë/m ³
Institucione buxhetore	105 lekë/ m ³	18 lekë/ m ³
Ente private	125 lekë/ m ³	20 lekë/ m ³

Klientë të veçantë 70 lekë/ m³ 20 lekë/ m³
(industri)

b) Tarifë fikse

	Furnizimi me ujë
Konsumator familjar	200 lekë muaj/klient
Institucione buxhetore	200 lekë muaj/klient
Ente private	200 lekë muaj/klient

c) Tarifë shitje uji me shumicë

Komuna Portëz (fshati Plyk): 26 lekë/ m³

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2014:

- Uji pa të ardhura (humbjet)	60 %
- Niveli i matjes	60 %
- Kohëzgjatja e furnizimi	22 orë/ditë
- Eficenca e energjisë	0.78 kwh/ m ³
- Efikasiteti i stafit	4.4 p/000/lidhje
- Mbulimi me ujë	96 %
- Mbulimi me kanalizime	62 %
- Norma e arkëtimit	75 %
- Cilësia e ujit (klor + koliform)	sipas standardeve.

3. Pagesa rregullatore vjetore për sh.a. UK Fier do të jetë 0.8 % e të ardhurave të llogaritura.

4. Ky vendim hyn në fuqi më 1.5.2014 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

5. Vendimi i KKRR-së nr. 36, datë 17.12.2012, "Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik", shfuqizohet.

KRYETARI
Avni Dervishi

KËRKESË

Shtetasi Leonard Lashi, i biri i Pandeliut dhe i Kalies, i datëlindjes 27.7.1976, lindur dhe banues në Fier, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, shpalljen të zhdukur të vëllait të tij, shtetasit Thoma Lashi.

KËRKUESI
Leonard Lashi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 16 lekë

Adresa: bulevardi “Gjergj Fishta”, pas ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006